

VENDIM
Nr.392, datë 19.5.2010

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË “GJON BUZUKU”,
SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës private të arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër, e cila do të ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Shkodrës.
 2. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër do të organizohet në dy fakultete:
 - a) Fakulteti i Drejtësisë, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në “Drejtësi”.
 - b) Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, që do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë në “Informatikë”.
 3. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike dhe me plotësimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:
 - a) Drejtësi;
 - b) Informatikë.
 4. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
 5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi e programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
 6. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
 7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha